



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Kolegjit Fama si më poshtë:

- 1.1 Administrim Biznesi, MBA, 120 ECTS;
- 1.2 Ekonomi, BA 180 ECTS;
- 1.3 Infermieri, BSc 180 ECTS;
- 1.4 Juridik, LLB, 240 ECTS;
- 1.5 Mami, BSc 180 ECTS;
- 1.6 Psikologji, BA 180 ECTS, dhe
- 1.7 Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja (Validim).

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tash e tutje KShC) me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsimin e lartë, me datë 11.06.2018 ka njoftuar të gjitha IAL-të se nuk do të toleroj mospërmbushje të kriterëve të cilat derivojnë nga dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e arsimit të lartë, dhe se në secilin rast të konstatimit të mungesës së stafit akademik sipas dispozitave ligjore në fuqi, do të procedoj me tërheqje të akreditimit.

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve sipas nenit 30 të UA për Akreditim, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësimit apo jo të kriterëve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, KShC analizoj në detaje të gjithë dokumentacionin e secilit staf akademik të vendosur si bartës të programeve nga Kolegji Fama. Pasi analizoj të dhënat rreth numrit të stafit dhe fushat e studimit për secilin program të studimit, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sipas pikës një (1) të nenit 21, të UA për Akreditim, *"AKA e rezervon të drejtën të monitorojë dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim"*. Sipas pikës dy (2), *"AKA mund të rishqyrtoj akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur"*.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Ndërsa në nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, thuhet: *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor"*, pra IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik më së largu deri me 31 tetor 2018. Sipas pikës 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, *"Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit"*.

1. Për programin e studimit: *Administrim Biznesi, MBA, 120 ECTS*, Kolegji Fama nuk ka paraparë asnjë person si bartës të këtij programi të studimit.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*. Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet të ketë të paktën dy staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Bazuar në pikën dy (2) të nenit 21 të UA për Akreditim, *"AKA mund ta rishqyrtoj akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur"*. Me këtë rast konsiderohet se mosvendosja e asnjë stafi të programit të studimit *Administrim Biznesi, MBA, 120 ECTS*, është ndryshim i kushteve të akreditimit, dhe mbi këtë bazë, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik për këtë program të studimit sipas pikës 5.3.4 të nenit 26 dhe bazuar në pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheqë akreditimin për programin e studimit *Administrim Biznesi, MBA, 120 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Ekonomi, BA, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Fama ka paraparë këta persona: Drita Shaqiri, Bedri Ademi, dhe Bedri Drini.

Sipas nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, *“Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc dhe Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar”*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, të referuar me sipër, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit rreth kualifikimit të stafit akademik të vendosur nga Kolegji Fama për programin e studimit, *Ekonomi BA*, u konstatua që vetëm Drita Shaqiri PhD në Administrim Biznesi, dhe Bedri Ademi PhD në Menaxhment i plotëson kriteret për të qenë bartës të këtij programi. Ndërsa stafi tjetër i prezantuar si bartës të këtij programi, Bedri Drini është PhD në Shkenca Teknike, fushë kjo e cila përket fushës së Ekonomisë, dhe i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheqë akreditimin për programin e studimit *Ekonomi, BA, 180 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Fama ka paraparë këta persona: Valdet Hashani, Armend Vuçitërna, Skender Telaku.

Sipas nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, *“Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc dhe Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar”*. Përveç asaj çka u tha me sipër, IAL-të duhet të kenë staf permanent nga fusha e studimit, të paktën me gradën MA.

Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji Fama për programin e studimit, *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, u konstatua që ky program nuk ka staf të mjaftueshëm të fushës së programit të studimit, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Valdet Hashani, është PhD në Lëndët paraklinike; Armend Vuçitërna është PhD në Lëndët Klinike, dhe Skender Telaku PhD në Sëmundjet e Brendshme, nuk i përkasin fushës së infermierisë, dhe të njëjtit nuk mund të jenë bartës të këtij programi. Bazuar në fushën e studimit të stafit të referuar me lartë, KShC erdhi në përfundim që asnjëri nuk i përket fushës së programit të studimit, andaj mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe

5.3.11 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Infermieri, BSc, 180 ECTS*.

4. Për programin e studimit: *Juridik, LLB, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Fama ka paraparë këta persona: Sheqir Kutllovci, Eqrem Zenelaj, Zeqirja Idrizi, dhe Avdi Smajllaj.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e UA së referuar më lartë, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji Fama për programin e studimit, *Juridik, LLB, 240 ECTS*, u konstatua që ky program nuk ka staf të mjaftueshëm të fushës së programit të studimit, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Sheqir Kutllovci është PhD në Siguri Kombëtare, Zeqirja Idrizi është PhD në Histori, dhe Avdi Smajllaj është PhD në Shkenca Politike. Bazuar në fushën e studimit të stafit të referuar më lartë, KShC erdhi në përfundim që asnjëri nga tre bartësit e cekur më sipër nuk i përketin fushës së programit të studimit, andaj mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe 5.3.11 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheqë akreditimin për programin e studimit *Juridik, LLB, 240 ECTS*.

5. Për programin e studimit: *Mami, BSc, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Fama ka paraparë këta persona: Hajrullah Latifi, Ilir Azizi, Gani Shabani.

Sipas nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, *“Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc dhe Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar”*. Përveç asaj çka u tha me sipër IAL-të duhet të kenë staf permanent nga fusha e studimit, të paktën me gradën MA.

Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji Fama për programin e studimit, *Mami, BSc, 180 ECTS*, u konstatua që asnjëri nuk i përket fushës së programit Mami, dhe me këtë rast nuk i plotësojnë kriteret për të qenë bartës të këtij programi. Hajrullah Latifi është PhD në Shkencat e Mjekësisë, Ilir Azizi është PhD në Shkencat e Mjekësisë, dhe Gani Shabani PhD në Lëndët Paraklinike. Bazuar në deklarin e Gani Shabani, konfirmohet se i njëjti ka

dy marrëdhënie të rregullta të punës, dhe atë me Kolegjin Rezonanca dhe në Kolegjin Fama, dhe mbi këtë bazë i njëjti nuk mund të pranohet si bartëse e këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe 5.3.11 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheqë akreditimin për programin e studimit *Mami, BSc, 180 ECTS*.

6. Për programin e studimit: *Psikologji, BA, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Fama ka paraparë këta persona: Qufli Osmani (PhD në Psikologji), Nazmije Ibishi-Musliu (PhD në Neuroshkencë, Pranvera Jetishi (PhD në Shkenca Sociale, profili: Psikologji-Pedagogji).

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji Fama për programin e studimit, *Psikologji, BA, 180 ECTS*, u konstatua që Qufli Osmani është deklaruar pas kalimit të afatit ligjor për deklarim të stafit akademik të IAL. Sipas nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor"*, pra Kolegji Fama ka qenë i detyruar që të deklaroj stafin akademik me se largu deri me 31 tetor 2018. Mbi këtë bazë i njëjti nuk mund të jetë bartës i programit të studimit. Ndërsa Nazmije Ibishi-Musliu, pas verifikimit nga AKA, rezulton të jetë në marrëdhënie të rregullt pune edhe në një institucion publik, e që është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditim.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe 5.3.11 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheqë akreditimin për programin e studimit *Psikologji, BA, 180 ECTS*.

7. Për programin e studimit: *Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja (Validim), MA, 120 ECTS*, Kolegji Fama nuk ka paraparë asnjë person si bartës të këtij programi të studimit.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD"*

nga fusha e programit të studimit". Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.9 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Fama, duhet të ketë të paktën dy staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.


Bazuar në pikën dy (2) të nenit 21 të UA për Akreditim, *"AKA mund ta rishqyrtoj akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur".* Me këtë rast konsiderohet se mos prezantimi e asnjë stafi të programit të studimit *Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja, MA 120 ECTS*, është ndryshim i kushteve të akreditimit, dhe mbi këtë bazë, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik për këtë program të studimit sipas pikës 5.3.4 të nenit 26 dhe bazuar në pikën dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja, MA 120 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Fama";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë